

**OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE
PLANI GJITHPËRFSHIRËS I KOMUNAVE, JANAR-DHJETOR 2023**

Data e dorëzimit të raportit:		
Emri i komunës	Kryeqyteti	
Emri i Kryetarit të Komunës	Përparim Rama	
Emri i Zyrtarit Komunal për IE :	Ajshe Bërveniku	
Detajet kontaktuese:		
<u>Pjesa e ZKIE-ve</u>	Vetëm për komunat që mund të kenë pasur ndonjë ndryshim.	
Zbatimi i rregullores Nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integrim Evropian	<p>1. Ju lutem specifikoni pozitën e ZKIE-së sipas akt emërimit ?</p> <p>2. A është themeluar Zyra Komunale për Integrim Evropian në komunën tuaj konform rregullores nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integrim Evropian ?</p> <p>3. A është emëruar Udhëheqësi i Zyrës për Integrim Evropian në komunën tuaj konform Rregullores nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integrim Evropian?</p> <p>4. Sa është numri i zyrtarëve në zyrën komunale për integrim evropiane?</p> <p>5. A janë të përfshira prioritetet dhe aktivitetet e fushës së Integrit Evropian në planet vjetore të komunës ?</p> <p>6. A merr pjesë ZKIE në takimet për planifikim të buxhetit vjetor në mënyre që të përfshihen edhe obligimet e Agjendes Evropiane në planifikimin buxhetor?</p> <p>7. A merr pjesë ZKIE në takimet e rregullta të Kryetarit të Komunës me</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kryeqyteti ka të themeluar Sektorin për Bashkëpunim Nërkombëtar dhe Integrim Evropian, është emëruar UD e udhëheqëses së Sektorit, tash për tash jemi në pritje të plotësimit të stafit tjetër të Sektorit; - Integrimi evropian është prioritet i qeverisjes lokale në Kryeqytet. Zyrtarja merr pjesë në komisionet për hartimin e dokumenteve, në procesin e riintegrit, me Zyrën për kthim dhe komunitete, si dhe në takime ku diskutohen çështje me prioritet;

	Drejtorët Komunal?			
Objektivat	Drejtoria komunale përgjegjëse	Masat	Përmbledhja e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit, janar - dhjetor 2023	Dispozitat e MSA-së
<ul style="list-style-type: none"> <u>BLLOKU I: KRITERET POLITIKE</u> 				
1. ADMINISTRATA PUBLIKE				Neni 120 i MSA-së: Administrata publike
1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal	Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ burimet njerëzore	1. A është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2023 në komunën tuaj? <i>Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë.</i>	1. Programi i trajnimeve është hartuar, e gjeni të bashkëngjitur si dokument;	
1.2. Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal	Zyra Kryetarit / Zyra informimit	1. A ka hartuar komuna juaj Startegjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkëngjiteni strategjinë e miratuar? 2. A ka komuna juaj Planin	1. Jo, Kryeqyteti nuk e ka hartuar dokumentin “Strategjia për komunikim me publikun”; 2. Po, Kryeqyteti e ka Planin vjetor të komunikimit, të cilin e gjeni të bashkëngjitur; 3. Udhëzimi administrativ nr. 06/2018,	

vjetor të komunikimit, nëse po ju lutem të bashkangjitni Planin ?

3. A është duke u zbatuar Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komunën tuaj?

4. A është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunën tuaj? Ju lutem bashkangjitni vendimin.

5. Lidhur me rezultatet e procesit të konsultimit publik, a publikon komuna juaj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe a ofron sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara. (ju lutem e bashkangjitni linkun e publikimit të raporteve)?

zbatohet;

4. Po, është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik: https://prishtinaonline.com/uploads/vendim_osman_bllaca.pdf

3.SHOQËRIA CIVILE			
<p>3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile</p>	<p>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</p>	<p>1. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve?</p> <p>2. Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna juaj ?</p> <p>3. A ka përkrahur komuna juaj, projekte të OJQ-ve për përkrahjen e komuniteteve.</p> <p>4. Nëse po, specifikoni numrin e projekteve të përkrahura dhe ju lutem ofroni shumën totale të këtyre projekteve?</p>	<p>1. Buxheti i ndare për vitin 2023, për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ka qenë në vlerë prej: 5.150.000.00 €,</p> <p>2. Gjatë vitit 2023, janë përkrahur financiarisht 354 projekte, në vlerë prej 1,627,714.76 €; - 7 çerdhe me bazë në komunitet, me vlerë 224.390.00 €,</p> <p>3. DMS ka përkrahur projekte të komuniteteve të OJQ-ve përmes “Thirrjes publike“;</p> <p>https://prishtinaonline.com/uploads/lista_e_perfituesve.xlsx</p> <p>4. OJQ “Fondacioni Terre Des Hommes Lausanne në Kosovë TDHK ”, Vlera e përgjithshme prej 6,000.00 € (gjashtë mijë euro) dhe OJQ “ Instituti Sink”, vlera e përgjithshme 5,100.00 € (pesë mijë e njëqind euro);</p>
4.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT			<p>Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA</p>

<p>4.1.Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre</p>	<p>Drejtoria a Arsimit/Zyra e Kryetarit</p>	<p>1. Në bashkëpunim me Ministrit e Linjës dhe institucionet/organizatat tjera a është organizuar ndonjë trajnim i detyrues për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm dhe se si të veprojnë në raste të tilla ?</p> <p>2. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?</p> <p>3. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?</p>	<p>- Sa i ërket këtij veprimi dhe 3 pyetjeve (indikatorëve), gjatë vitit 2023 nuk kemi pasur asnjë rast të ekstremizmit radikal në shkolla, asnjë rast të paraqitur në KKSB, andaj nuk janë marrë aktivitete, por as iniciativë për ndonjë trajnim nga niveli qëndrorë ose organizata nuk ka pasur;</p>	
<p>4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. Sa është numri i rasteve të paraqitura të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese kanë qenë dy raste që janë dërguar në Agjencinë Antikorrupsion, për njëjën kemi marrë përgjigje, ndërsa për tjetrin ende jo;</p> <p>2. Gjatë periudhës raportuese nuk kemi pasur raste të paraqitura të konfliktit të interesit</p>	

<p>e pasurisë dhe konfliktin e interesit , si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit</p>		<p>2. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës?</p>	<p>nga anëtarët e Kuvendit;</p>	
<p>4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit;</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, konform ligjit Nr. 03/1- 159 për agjencinë kundër korrupsionit nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj koordinator që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet, nëse po ju lutem të bashkangjiteni vendimin.</p>	<p>1. Po, është miratuar Plani i integritit, në mbledhjen e nëntë të Kuvendit, më 30.11.2023; https://prishtinaonline.com/uploads/6_vendim_lidhur_me_planin_e_integritetit.pdf</p> <p>2. Jemi në proces të emërimit të koordinorit që monitoron dhe raporton rreth këtij Plani;</p>	
<p>4.4.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve</p>	<p>Zyra ligjore/Zyra informimit</p>	<p>1 Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët në përdorim në</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës ka zyrtarë për përkthim në gjuhën serbe, ku të gjitha lajmet, vendimet, rregulloret përkthehen në gjuhët zyrtare;</p> <p>2. Të gjitha vendimet, rregulloret publikohen në gjuhë zyrtare: Vendimet: https://kk.rks-gov.net/prishtine/sr/category/odluke/</p>	

zyrtarë?

2.A publikohen të gjitha aktet komunale në gjuhët zyrtare ashtu sic parashihen me ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe rregullores komunale për gjuhët zyrtare?

Rregulloret: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/sr/category/pravilnici/>
Lajmet: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/sr/vesti/>

Rregullore për përdorimin e gjuhëve: <https://prishtinaonline.com/uploads/110-286.pdf>

5. MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE

<p>5.2.Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p>Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore konform Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore ?</p> <p>2. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ?</p> <p>3. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?</p> <p>4. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?</p> <p>3.A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?</p> <p>6. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? (Vetem komunat që kanë kisha) ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Komuna e Prishtinës nuk ka sektor të veçantë për Trashëgimi Kulturore; - Projektet që kanë të bëjnë me trashëgimi Kulturore, të gjitha bëhen në koordinim me Institucionet përkatëse për Trashëgimi Kulturore, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prishtinë dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore; <p>Komuna e ka përgatitur Planin zhvillimor komunal 2021-2029, ku përfshihet edhe plani për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore;</p>
---	--	--	--

<p>5.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p>Drejtoria e Kulturës</p>	<p>1.Listoni aktivitetet që komunat ka ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitetet gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2023 janë : - Drejtoria e Kulturës ka projekte të ndryshme për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Promovimi bëhet në kuadër të promovimit turistik të qytetit të Prishtinës, ndërsa mbrojtja e trashëgimisë bëhet me anë të projekteve të konservimit dhe restaurimit të ndërtesave dhe pjesëve të Qytetit, në bashkëpunim me institucionet kompetente; - Në bashkëpunim me UNDP-në, Drejtoria e Kulturës ka implementuar konservimin dhe restaurimin e Sahatkullës, përmes së cilës është bërë edhe trajnimi i studentëve në këtë fushë.Projekti ka përfunduar me sukses dhe ka pasur impakt pozitiv. - Drejtoria e Kulturës poashtu e ka bërë lyerjen dhe ndriçimin e fasadave të SHFMU “Elena Gjika”, si dhe Arkivit të Qytetit, të cilat janë ndërtesa në listën e Trashëgimisë Kulturore; - Kanë përfunduar punimet e projektit: ” Regjenerimi i rrugës Mehmet Kaçurri” (rruga Model) në Zonën e vjetër të qytetit, e ciila do të shëbejë si model për regjenerimin e pjesëve tjera në zonën historike të kryeqytetit. <p>Po ashtu, përmes subbencioneve kemi një numër të projekteve që janë përkrahur për trashëgimi</p>	
--	-----------------------------	--	---	--

kulturore;

2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE

1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT

1.1. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes si dhe procedurat e planifikimit të buxhetit

**Drejtoria për
Zhvillim
Ekonomik**

1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (*one-stop shopet*) në komunën tuaj?

2. Sa është numri i inspektorëve të tregut në komunën tuaj?

3. Sa është numri i inspektimeve gjatë periudhës raportuese?

4. Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit?

1. Jo, nuk është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve, ARBK është në qytetin e Prishtinës dhe qytetarët e kryejnë shërbimin direkt;
2. Inspeksioni i tregut tashmë është kompetencë e Ministrisë së Tregtisë;
3. N/A
4. Janë mbajtur 5 dëgjime buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitin 2024:
<https://kk.rksgov.net/prishtine/drejtorite/financa/ekstraket-e-procesverbaleve-te-degjimeve-buxhetore/>

2. TATIMET

Neni 105 Tatimet - MSA

2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;

**Drejtoria e
Inspektoriatit**

1. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale ?

1. Siç e kemi cekur edhe në raportet e kaluara, inspektorat që inspektojnë tregun janë kompetencë e nivelit qendror;

<p>2.2. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike</p>		<p>1. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuaj.</p> <p>2. Sa rekomandime të ZKA-së i keni adresuar?</p> <p>3. Sa rekomandime të ZKA-së kanë mbetur pa u adresuar?</p> <p>4. Sa rekomandime të ZKA-së gjenden në proces?</p> <p>5. A funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm në komunën tuaj, nëse po sa zyrtarë janë të angazhuar në këtë njësi?</p> <p>6. A ka themeluar komuna juaj komitetin për auditim të brendshëm?</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës për këtë vit ka marrë opinion “e kualifikuar”. Komuna ka hartuar Planin për implementimin e rekomandimeve. Në Plan janë paraparë të gjitha veprimet të cilat do të ndërmerren për përmirësimin e të gjeturave. Poashtu, janë caktuar zyrtarët përgjegjës për ato rekomandime, si dhe janë caktuar afatet kohore;</p> <p>2. ZKA në raportin e fundit janë dhënë 22 rekomandime;</p> <p>3. Janë zbatuar 10 rekomandime;</p> <p>4. Kanë mbetur 8 pa u zbatuar;</p> <p>5. Ndërsa 4 rekomandime janë në proces;</p> <p>6. NJAB funksionon në Komunën e Prishtinës dhe ka 5 auditorë;</p> <p>7. Gjatë vitit 2023 janë bërë 12 auditime;</p> <p>8. Janë kryer dy auditime në Drejtorinë e Urbanizimit, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë e Shëndetësisë, Prokurim, Drejtorinë e Kulturës, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Financave - Tatimi në pronë, Drejtorinë e Sportit, Pagat, Drejtorinë e Administratës, ndërsa në Arsim dhe Kulturë janë bërë nga dy auditime.</p> <p>9. Auditim i performancës është bërë në Zyrën e prokurimit;</p>	

2.3. Planifikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal		1. A është publikuar regjistri i pronës komunale, bashkangjitni linkun i regjistrit të pronave në kuadër të ueb faqeve zyrtare të komunave ?	1. Lista e pronave të paluajtshme komunale: https://kk.rks-gov.net/prishtine/prone/lista-e-pronave-komunale/	
3. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT E INDUSTRIË 13				
3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve		1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën tuaj?	1. Jo, nuk është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike;	
3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE				
1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL				Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria
1.1. Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore	Drejtoria për Bujqësi	1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nëse po ju lutemi na bashkangjitni planin e miratuar? 2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore? 3. Sa është numri i vendimeve të miratuara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?	1. Jo, Komuna nuk e ka Planin për bujqësi dhe zhvillim rural; 2. Gjatë vitit 2023, kanë qenë 24 kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës: - 20 të miratuara; - 1 e refuzuar; - 3 në procedurë; - 16 të miratuara nga MBPZHR (në këtë shifër ka edhe përgjigje nga viti i kaluar);	

<p>1.2.Konsolidimi i mëtejshëm i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p>	<p>1. A janë funksionalizuar qendrat informative për këshillimin e fermerëve në komunën tuaj?</p> <p>2.A ka mbështetur komuna juaj fermerët në sektorin e drithrave, hortikulturës, blegtorisë etj nëse po ju lutem cekni sektorin dhe numrin e fermerëve të përkrahur?</p>	<p>1. Qendra për trajnimin e fermerëve është themeluar dhe është funksionale;</p> <p>2. Gjatë periudhës raportuese, janar – dhjetor 2023, Drejtoria e Bujqësisë së Kryeqytetit ka përkrahur fermerët në fusha të ndryshme të bujqësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Blegtori, pagesa direkte, 230 fermerë përfitues; - Shpeztari, pagesa direkte, 6 fermerë përfitues; - Bletari, pagesa direkte, 200 fermerë përfitues; - Furnizim me serra me sip. 0.05Ha, gjithsej 25 fermerë përfitues; - Mekanizim bujqësor, 90 fermerë përfitues; - Rrotoballer me pajisje përcjellëse, 4 fermerë përfitues; - Freza për traktor, 68 fermerë përfitues; - Mikser për ushqim voluminoz të kafshëve, 9 fermerë përfitues; - Shpërndarës për pleh të stallës (rimorkio), 9 fermerë përfitues; - Bashkpunim mes Kryeqytetit, konkretisht Drejtoria e Bujqësisë me sistemin e ujitjes “Ibër – Lepenc” për ujitje gjatë sezonit, 51 fermerë përfitues; - Aplikacione për MBPZHR, 1250 fermerë aplikues; - Tregu mobil, 40 fermerë përfitues; - “Islamic Relief Kosova” në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë së Kryeqytetit, ka përkrahur 54 fermerë me motokultivatorë; 	
<p>1.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p>	<p>1. A ka komuna juaj inspektor të bujqësisë?</p> <p>2. Në rast se komuna juaj nuk ka inspektorë të bujqësisë, kush e realizon këtë funksion ?</p>	<p>Sa i përket çështjes së Inspeksionit, e kemi sqaruar edhe në raportet e kaluara edhe më lart, ndër sektorët e Inspeksionit që kompetenca i ka kaluar në nivel agjencie janë edhe inspektorët bujqësorë;</p>	

		<p>3. Sa është numri i inspektimeve?</p> <p>4.A keni raste në komunën tuaj të humbjes së tokës Bujqësore? .</p> <p>5.Nëse po, çfarë veprime ka ndërmarr komuna juaj për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore?</p>		
1.4. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi)	Drejtoria e Bujqësisë	1. A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?	1. Jo, Kmuna nuk e ka Planin për menaxhimin e tokës rurale;	
ENERGIJA				Neni 114 Energjia- MSA
2.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike	<p>1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqencë të Energjisë, konform Ligjit për Energji Elektrike nëse po, ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?</p> <p>2. Cilat janë projektet konkrete për zbatimin e planit për eficencë të energjisë, specifikoni së paku tri projekte?</p>	<p>1.Trajnimi dhe hartimi i Palnit komunal për energji dhe klimë është në procedurë, me asistencë teknike nga GIZ, po ashtu edhe është financuar;</p> <p>2.Projekti i zgjerimit të ndriçimit publik, ku deri më tani janë realizuar 128 rrugë, me gjatësi 41.1km dhe 1461 trupa ndriçues, si dhe ndërrimi i lllmpave nga 250WNa në 150W LED, sasia mbi 170copë;</p>	

4. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE				
4.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut	Njësia për të Drejtat e Njeriut	<p>1. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?</p> <p>2. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen e diskriminimit ?</p> <p>3.A është emëruar zyrtari përkatës për Barazi Gjinore?</p> <p>4. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ?</p>	<p>Njësia për të drejtat e njeriut është themeluar në vitin 2008, me vendim, dhe janë caktuar zyrtarët përkatës.</p> <p>1.Koordinatorë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, Premtime Preniqi,</p> <p>2. Zyrtare për të drejtat e femijëve, Lindita Hajdari (udhëheqëse në Drejtorinë e Kulturës</p> <p>3. Zyrtar për të drejtate e barabarta – Fahri (në pension)</p> <p>Në vitin 2018, kur janë bërë aktemrimet e reja, ka pësuar ndryshim dhe krejt pozitat tjera janë deleguar, si zyrtare për koordinimin e të drejtave të njeriut në përshkrim të punës,</p> <p>1. Zyrtare për koordinimin e të drejtave të njeriut – (Aktemerimi) Pozitat në përshkrim të punës</p> <p>1. Zyrtare për barazi gjinore,</p> <p>2. Zyrtare për të drejtate e fëmijëve,</p> <p>3. Zyrtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara,</p> <p>4. Zyrtare për mbrojtje nga diskriminimi dhe</p> <p>me vendim, zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale</p>	

<p>4.2 Zbatimi i pakove ligjore për Kujdesin për të moshuarit</p>		<p>1.A ofron Komuna juaj përkujdesje rezidenciale për të moshuarit, konform legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?</p> <p>2.Nëse po, sa qendra të përkujdesjes për të moshuarit gjenden në Komunën tuaj?</p>	<p>1. Është Institucioni i kujdesit rezidencial, që ofron shërbime dhe strehim për personat e moshuar pa përkujdesje familjare;</p> <p>2. Po, është një (1) qendër, Shtëpia për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare, në Prishtinë – SHPMMPF;</p>	<p>Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmeje Minsitrisë së Financave dhe Transfereve dhe Komunës së Prishtinës</p>
---	--	---	--	--

<p>4.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Strategjinë kundër dhunës në familje, konfrom strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?</p> <p>2. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konfrom strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?</p> <p>3. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj ?</p> <p>4.Cfarë masa ka ndërrmar komuna juaj për viktimat e dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje ?</p> <p>5.A ka themeluar komuna këshillin komunal (komitet) për mbrojtën e viktimave te dhunës në familje, nëse po sa takime janë mbajtur?</p>	<p>1. Po Kryeqyteti ka hartuar Planin lokal të veprimit kundër dhunës në familje, 2023-2026; https://prishtinaonline.com/barazia-gjinore</p> <p>3. DMS ka mbështetur me përkrahje financiare, përmes subvencioneve, 23 raste të viktimave të dhunës në familje;</p> <p>4.Mekanizmin kundër dhunës në familje dhe mban takime të rregullta. Këtë vit ka mbajtur 6 mbledhje.</p>	
---	---	--	---	--

<p>4.3.Të fuqizohet roli dhe pozita e grave në shoqëri</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut</p>	<p>1. Sa është numri i grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj) ?</p> <p>2.Sa është numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë ?</p> <p>3. Sa është numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tuaj?</p>	<p>1. Nga 18 drejtori në qytetin e Prishtinës, 7 drejtori udhëhiqen nga drejtore gra,</p> <p>2. Shërbimi civil, Shërbimi publik, Shtëpia për kujdesin e të moshuarve, si dhe Qendra për punë Sociale, i ka gjithsej 625, nga ta 316 femra, 309 burra</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në Kuvendin komunal të Kryeqytetit (2021 – 2025), janë 51 anëtarë, nga ta 17 femra dhe 34 burra; - Në Institucionet shëndetësore të Kryeqytetit janë 53 femra në pozita menaxheriale; <p>Në institucionet edukativo- arsimore në Kryeqytet janë të punësuar në pozitën menaxheriale gjithsej 39 femra.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në SHFMU janë të punësuar 16 drejtore dhe tetë (8) zëvendësdrejtore; - Në SHML janë të punësuar pesë drejtore (5) dhe dy (2) zëvendësdrejtore dhe - Në IP janë të punësuar tetë (8) drejtore. 	
<p>4.4.Zbatimi i të drejtave pronësore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore</p>	<p>1. Cilat janë veprimet që ka ndërmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?</p>	<p>1. UA për regjistrimin e pronës së përbashkët të dy bashkëshortëve. Kemi mbajtur edhe trajnime për të drejtën pronësore.</p>	

		2. Sa prona janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve?	2. Gjatë periudhës raportuese, sipas UA-së, janë regjistruar në emër të të dy bashkëshortëve gjithsej 563 prona;	
4.5. Zbatimi i Ligji për Mbrojtjen e fëmijës		<p>1. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqësohet komuna juaj në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës?</p> <p>2. A ka ndonjë mekanizëm të veçantë komuna e juaj me të cilin promovohet dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve ?</p> <p>3. A është organizuar ndonjë fushatë vetëdijësueses-edukese në komunën tuaj mbi promovimin dhe njohjen e të drejtave të fëmijëve në komunën tuaj,</p> <p>4. A është caktuar njësi apo zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës ?</p> <p>5. A janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, hapësirat e punës në institucionet lokale?</p>	<p>1. Fëmijët në situat rruge, për shkak se shumica janë nga vendet tjera dhe mosbashkëpunimi me komunat nga vin dhe shteti tjetër.</p> <p>2. Mekanizmat për promovimin e të drejtave të fëmijëve janë: Asambleja e Fëmijëve; Ekipi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;</p> <p>3. Aktivitetet:</p> <p>- 16.1.2023, mbledhja e parë e Asamblesë së Fëmijëve – Komuna e Prishtinës. Hapjen e kësaj mbledhjeje, si mandat i ri, e ka bërë kryetarja e posa zgjedhur, Verda Muqaj, dhe pastaj ia ka kaluar fjalën nënkryetarit, Noar Krasniqi, një herësh edhe ish-asamblistë i mandatit të kaluar, ku ka bërë një përmbledhje të punës nga mandati i kaluar 2-vjeçar dhe më pastaj kemi hartuar edhe planin e punës 2023, për Asamblenë e Fëmijëve.</p> <p>- Në bashkëpunim me UNDP-në dhe Asamblenë komunale të fëmijëve, në kuadër të projektit “Fondi për eksperimentin e Qytetit të UNDP-së, i cili po synon të përfshijë fëmijët e Prishtinës në kookrijim të hapësirave publike dhe parqeve, që ato të jenë sa më të përshtatshme dhe miqësore për vajza</p>	

6.A janë të qasshme objektet arsimore për personat me aftësi të kufizuar?

7.A kane asistencën e duhur në procesin mësimor personat me aftësi të kufizuar, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?

8. A ofron Komuna Juaj kujdestari për fëmijës pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi.

dhe djem.

- Në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, si pjesë e projektit "Përfshirja e fëmijëve si qytetarë aktivë në promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe perspektivës gjinore", është mbajtur takimi me Asamblennë e Fëmijëve, ku Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, mori pjesë në këtë takim, me temën "Të drejtat e fëmijëve dhe barazia gjinore".

Avokati i Popullit u shpjegoi fëmijëve rolin dhe mandatin e tij, punën dhe aktivitetet ditore në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe procedurat e ankesave që mund të kenë fëmijët. Ai tha se Institucioni i Avokatit të Popullit ka një departament të veçantë që punon për të drejtat e fëmijëve, që nga promovimi dhe mbrojtja, e deri në hetimin e ankesave.

Z. Qelaj shpjegoi se IAP ka pranuar 77 ankesa gjatë vitit 2022, me pretendime për shkelje të të drejtave të fëmijëve. Ai foli për të drejtën e fëmijës në arsim, sfidat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara, të drejtat e fëmijëve në procedurat e organeve gjyqësore, mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve e të tjera.

Takimi pasoi me pyetje të ndryshme të pjesëmarrësve. - Në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit, më 8 mars, organizuam aktivitetin vetëdijësues me moton "super çikat e Prishtinës". Gatë këtij aktiviteti u hap ekspozita e nxënësve, ndërsa në bashkëbisedim pjesëmarrëse ishin gra që kanë thyer stigmat me zgjedhje në karrierë.

Aktiviteti u udhëheqë nga Verda Muqaj, kryetare e Asamblesë së Fëmijëve në Prishtinë, Pjesëmarrës për një fjalë rasti ishte kryetari i Kryeqytetit, z. Përparim Rama dhe nxënësit që dëgjuan tregimet personale të grave, si togere Ilirjana Bunjaku, programere Zana Tabaku, kapitene policie Begishe Krasniqi, alpiniste Mrika Nikçi, shofere autobusi Laura Mirena dhe nënkryetare e Kryeqytetit, Donjeta Sahatçiu.

9. - Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, është mbajtur trajnim për Asamblenë e Fëmijëve, me temë: “Dukuritë negative nëpër shkolla”.

- Në bashkëpunim me organizatën “Syri i Vizionit” dhe “Save the Children”, Zyra në Kosovë, është mbajtur trajnim për asamblenë e fëmijëve, me temë: “Metodologjitë praktike të avokimit dhe rritja e përgjegjësisë dhe transparencës së institucioneve”.

Qëllimi i këtij trajnimi është fuqizimit i Asamblesë së Fëmijëve në përfaqësimin dhe përfshirjen në vendimmarrje, aty ku preket interesi më i mirë i fëmijëve dhe rritja e përgjegjësisë e transparencës së institucioneve gjegjëse në komunë dhe qeveri.

- Asambleja e Fëmijëve në bashkëpunim me organizatën DYVO dhe “Save the Children”, shënuan Ditën e tokës.

Qëllimi i këtij aktiviteti është ta mbrojmë tokën nga mbeturinat e plastikës, duke i shfrytëzuar ato për punim të ndryshme;

- Më 1 qershor, u mbajt mbledhja solemne e Asamblesë së Fëmijëve të Kryeqytetit, me moton “Prishtina e Fëmijëve”, më pas kemi vazhduar me aktivitete të tjera, ku jemi ftuar nga “Save the Children”, me moton “Unë kam një ligj që më mbron”.

- Me rastin e Ditës ndërkombëtare të fëmijës vajzë, më 11 tetor, në bashkëpunim me OJQ “Qendra Kosovare për Studime Gjinore”, së bashku me vajzat e Asamblesë së Fëmijëve të Kryeqytetit, vizituam Kompaninë Kosovare për Distribuium me Energji Elektrike në Kosovë. Në këtë takim ishim mysafir të ministres, znj Rizvanolli, ku inkurajoi vajzat të ndjekin pasiononte e tyre pa menduar për paragjykimet, ose kufijtë e vendosur nga stereotipet shoqërore.

- Organizimi i fushatës “Tetori muaji kundër trafikimit me

qenien njerëzore”, moto: “Bashkë kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, si dhe lansuar video me mesazhe. Mbledhja e mbajtur në sallën e Kuvendit, ku hapjen e kësaj fushate e bëri kryetari i Kryeqytetit, z. Rama, pastaj diskutuam fenomenin dhe mekanizmat mbështetës pranë Kryeqytetit, përmes Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, bashkë me Policinë e Kosovës dhe Qendrën e qëndrimit ditor për fëmijë në situatë rruge. U shfaqën video-mesazhe të punuara nga Asambleja e fëmijëve të kryeqytetit. Në fund u hap ekspozita se si nxënësit e shkollave tona shohin trafikimin në formë artistike, me pikturim.

- Me rastin e Ditës së Konventës evropiane për të drejtat e fëmijëve, është prezantua raporti i tyre “Ndryshimet që duam t’i shohim” gjatë takimit të Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës, ku kryesia e Asamblesë së Fëmijëve të Kryeqytetit - kryetarja Verda Muçaj, e cila theksoi zotimet e vendimmarrësve në nivel lokal në fushën e qëndrueshmërisë klimatike dhe mbrotjes së mjedisit, duke prezantuar investimet kapitale të parapara nga disa komuna në përmirësimin e mjedisit gjatë mandatit qeverisës 2021-2025.

Zv.kryeministrja znj. Emilija Rexhepi, u premtoi fëmijëve që do bëjë çmos, që të adresojë nevojat dhe kërkesat e fëmijëve në bashkëpunim me ministrinë përkatëse.

Gjithashtu, në bashkëpunim me “Save the Children”, Asambleja e fëmijëve të Kryeqytetit kanë qenë pjesë e emisioneve të ndryshme.

#NdryshimetqëDuamtiShohim”

- Asambleja e Fëmijëve ka zhvilluar një fushatë kundër dhunës, me fokus kryesor në rolin kyç të edukimit në

parandalimin e dhunës dhe promovimin e zgjidhjeve paqësore, me theks të veçantë në ndërmjetësimin e bashkëmoshatarëve.

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj fëmijëve, ndikojnë në rritjen e shëndetshme psikike dhe fizike të fëmijëve.

Në bashkëpunim me organizatën DYVO dhe Asamblenë e Fëmijëve të Kryeqytetit, nga data 23.24.25, kemi organizuar aktivitet.

Qëllimi i aktivitetit ishte rregullimi i bredhit te festave të fundvitit, me elemente të ripërdorshme kreative. Përveç rregullimit të dekoreve kreative me materiale të ripërdorshme, aktiviteti synon edukimin dhe angazhimin e të rinjve në praktika të qëndrueshme në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të plastikës, duke promovuar gjithashtu aftësitë e të menduarit kreativ dhe zgjidhjes se problemeve.

Dita 1: Punëtori e ripërdorimit dhe aktivitetet e klasifikimit të plastikës;

Dita 2: Punëtori e dizajnit dhe krijimit;

Dita 3: Festimi i Ditës së Krishtlindjes dhe zbulimi i bredhit;

4. Jo , vetëm në përshkrim të punës;

5. Po, por ende ka nevojë për përmirësime;

6. Të gjitha shkollat i kanë pjerrinat që lehtësojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara në objkte;

7. Sa i përket asistencës, përkundër kërkesave të mëdha, janë të angazhuara 24 asistente dhe jemi në pritje të angazhimit edhe të 25 të tjera;

8. Komuna e Prishtinës e ka të themeluar Qendrën per Punë

			<p>Sociale, e cila është e mandatar për të ofruar shërbime për fëmijët dhe familjet. Sipas legjislacionit primar dhe sekondar që e rregullojnë fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe përgjegjësinë e institucioneve, Organi i Kujdestarisë është përgjegjës për të kryer të gjitha veprimet për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe të aplikojë format e mbrojtjes juridike dhe sociale në përputhje me interesat e fëmijës dhe legjislacionit në fuqi:</p>	
--	--	--	--	--

- kujdestaria,
- strehimi familjar,
- strehimi rezidencial,
- adoptimi,
- jetesa e pavarur, e mbikëqyrur.

4.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	<p>1. A është e hapur dhe funksionale strehimorja për viktimat e trafikimit në komunë tuaj? (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë)</p> <p>2.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeçar për strehim Social konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit ? Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin?</p>	<p>1. Po, në Prishtinë funksionon Strehimorja për Viktimat e Trafikimit, dhe ne si DMS e kemi përkrahur me projekte përmes “Thirrjes publike”;</p> <p>https://prishtinaonline.com/uploads/lista_e_perfituesve.xlsx</p> <p>2. Jo, nuk eshte miratuar Plani Trevjeçar për banim Social;</p>	
4.7.Incimi i funksionalizmit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar		<p>1. A është themeluar Komiteti konsultative për Personat me aftësi të kufizuara në komunën tuaj?</p>	<p>1. Komiteti është themeluar dhe ka pasur mandat deri në korrik 2023, nga përfundimi i mandati nuk eshte më funksional dhe nuk është caktuar tjetër;</p>	

<p>4.8. Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie</p> <p>7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan.</p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1.A është funksionalizuar Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas ? (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë).</p> <p>2. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konform Ligji nr. 04/1-017 për ndihmë juridike falas</p> <p>3. Sa është numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në komunën tuaj?</p>	<p>1.Përfituesit e shërbimeve sociale e shfrytoznë shërbimin e ndihmës juridike falas përmes Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;</p>	
<p>5 .MBROJTJA E MINORITETEVE</p>				
<p>5.1.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal</p>		<p>1.Sa është numri i të punësuarave në të gjitha institucionet e komunës, nga komunitet jo shumicë në pajtim me përqindjen e popullatës në komunë ?</p>	<p>1. Në Kryeqytet, nga 625 shërbyes civilë publikë, QPS dhe Qendra per Kujdesin e të Moshuarve,</p> <ul style="list-style-type: none"> - 559 jane shqiptarë, - 2 boshnjak, - 1 ashkali, - 8 serbë, - 2 turq. 	

<p>5.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, dhe ashkali</p>	<p>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</p>	<p>1. A është realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom dhe Ashkali?</p> <p>2. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni këtë Plan? (për komunat që i kanë këto komunitetet)</p> <p>3. A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian</p>	<p>1. Po, është realizuar fushata për regjistrimin falas të komuniteteve Rom dhe Ashkali, në periudhën njëmuajore, 15 qershor - 15 korrik;</p> <p>2. Në mbledhjen e datës 27.06.2023, është miratuar Plani lokal i veprimit për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian : https://prishtinaonline.com/uploads/8_vendim_plan_i_lokal_i_veprimit_per_komunitetin_rom_ashkali_dhe_egjiptian_ne_k.p.pdf</p> <p>3. Është themeluar dhe është funksional;</p>	
<p>6. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA</p>				<p>Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA</p>

<p>6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafuar</p>	<p>Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete</p>	<p>1.A është miratuar Planit Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2.A ka themeluar komuna juaj Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR)?</p>	<p>1. Me vendimin e datës 18 janar, është themeluar Komisioni komunal për hartimin e Planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve; Planit është miratuar në mbledhjen e datës 28 prill 2023. Vendimin për miratimin e Planit e gjeni ne linkun në vazhdim: https://prishtinaonline.com/uploads/6._vendim_per_miratimin_e_planit_komunal_per_riintegrimin_dhe_integrimin_e_qendrueshem_te_personave_te_riadhesuar_dhe_te_huajve_ne_komunen_e_prishtines_2023-2025_1.pdf</p> <p>2. Po, është themeluar dhe është funksional; Vendimi i datës 11.03.2022, me nr. 01-14-020/04-54807/22.</p>	
<p>7.MENAXHIMI I KUFIJVE DHE MIGRIMIT</p>				<p>Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni- MSA</p>
<p>7.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur</p>	<p>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale</p>	<p>1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i shtëpive të (ri)ndërtuara për të rikthyerit?</p> <p>3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim?</p>	<p>1. Gjatë priudhës raportuese nuk kemi pasur raste të personave të zhvendosur të rikthyer;</p> <p>2. Nuk ka pasur kërkesa për ndërtimin e shtëpive;</p> <p>3. Gjatë kësaj periudhe i kemi 10 raste në skemën e qirasë dhe asistencë;</p> <p>4. Kompetencë e MPB dhe MPMS;</p>	

		<p>4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?</p>		
<p>7.2. Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVS) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive</p>	<p>Zyra e Kryetarit Komunës</p>	<p>1. A është themeluar KKS në Komunën Tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKS ?</p> <p>3. A është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?</p> <p>4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?</p> <p>5. A është themeluar EVS në Komunën tuaj?</p> <p>6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?</p>	<p>1. KKS – është themeluar më 21.3.2022, me mandat katërvjeçar;</p> <p>2. Takimet e mbajtura për vitin 2023, gjithsej janë gjashtë (një e jashtëzakonshme dhe pesë të rregullta);</p> <p>3. Në Komunën e Prishtinës janë themeluar gjithsej dhjetë (10) KLSP, në tri Stacione Policore (St. Policor “Veriu”, “Jugu” dhe “Qendra”);</p> <p>4. Takimet e KLSP – ve janë mbajtur mujore (secila KLSP – ka mbajtur takime mujore);</p> <p>5. EVS ka qenë e themeluar, por nuk ka funksionuar, për arsye të largimit të anëtarëve, dhe nuk është bërë rivitalizimi i listave të anëtarëve;</p> <p>6. Nuk është mbajtur asnjë takim;</p>	

		<p>7. A janë themeluar Këshillat e Fshatrave në komunën tuaj konform Udhezimi Administrativ 02/2019 MAPL për bashkpunimin e komunës me fshatra, nëse po të bashkëngjiten vendimet përkatëse?</p> <p>8. Sa takime kanë mbajtur në këtë periudhë?</p>	<p>7. Sa i përket procesit të themelimit të Këshillave të fshatrave, nga gjithsejtë 34 këshilla lokale (qytet dhe fshatra), 13 janë mbajtur dhe nga 9 vende ku janë zgjedhur, jemi duke pritur certifikimin e të zgjedhurve. Nga muaji mars presim vazhdimin me zgjedhjen e këshillave tjerë;</p>	
8. ARSIMI DHE KULTURA				Neni 107 Arsimit dhe trajnimi - MSA
8.1. Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës	Drejtoria e Arsimit	1. Sa trajnime janë mbajtur gjatë periudhës raportuese për mësimdhënës ?	1. Gjatë periudhës raportuese nuk janë mbajtur trajnime me karakter të tillë. Por DKA gjatë planifikimit të trajnimeve, në vazhdimësi ka prioritet edhe trajnimin e mësimdhënësve në këtë fushë;	

<p>8.2. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta</p>	<p>Drejtoria Arsimit e</p>	<p>1. Sa është numri i çerdheve funksionale (<i>publike dhe jo-publike</i>) në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjec që janë të përfshirë në çerdhe?</p> <p>3.Sa është numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe?</p>	<p>1. Në kuadër të Komunës së Prishtinës funksionale janë 8 çerdhe publike dhe 8 çerdhe me bazë në komunitet, si dhe një me partneritet publiko-privat. Ndërsa çerdhet private nuk menaxhohen nga Komuna e Prishtinës;</p> <p>2. Në çerdhe publike gjithësej janë 1610 fëmijëtë moshës 0-5 vjeç, dhe 985 në çerdhe me bazë komunitet;</p> <p>3. Gjithsej në çerdhet publike numri i fëmijëve me nevoja të veçanta është 36;</p>	
<p>8.3. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti RAE. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit</p>	<p>Drejtoria Arsimit e</p>	<p>1.Komuna juaj a has në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë?</p> <p>2.Sa është numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?</p> <p>3.A ka organizuar komuna juaj trajnime për ekipet e parandalimit të braktisjes së shkollës, nëse po ju lutem specifikoni numrin e trajnimeve?</p> <p>4. A ka hartuar komuna juaj Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës nuk ka hasur në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë;</p> <p>2. Sipas të dhënave për vitin 2022-2023, janë dy nxënës braktisës të komunitetit jo shumicë;</p> <p>3. Pasi që ekipet për parandalimin e braktisjes janë të formuara, Drejtoria e Arsimit do të bëjë planifikimin;</p> <p>4. Jemi në proces të hartimit të planit të veprimit kundër parandalimit të braktisjes;</p> <p>5. Të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës kanë të formuara ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve</p>	

		<p>dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) konform strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan?</p> <p>5. A janë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla në komunën tuaj?</p>	në shkolla;	
9. MJEDISI				Neni 115 Mjedisi- MSA
9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë	Drejtoria e Shërbimeve Publike	<p>1. A është hartuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit nr. 04/1-060 për mbeturina. Nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. Sa është numri i fushatave të ndërmarrja për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të</p>	<p>1. Po, kemi hartuar Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave, dhe bashkë me të kemi hartuar edhe Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, ku këto të dyja janë votuar në Asamblenë komunale;</p> <p>https://prishtinaonline.com/uploads/1._rregullorja_per_menagjimin_e_mbeturinave.pdf</p> <p>2. Deri tani janë ndërmarrë dy fushata vetdijesuese nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ku njëra ndër to edhe në bashkëpunim me Ministrinë, ndërsa dy të tjera janë ndërmarrë në bashkëpunim me ndërmarrjen “Pastrimi”;</p> <p>4 Po, Komuna e Prishtinës, gjegjësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike ka hartuar Planin për veprimin e</p>	

		<p>mbeturinave?</p> <p>3. Cilat janë veprimet e ndërrmara nga komuna e Obiliqit për mbrojtjen e qytetarëve lidhur me mbylljen e liqenit të deponitës së hirit të qymyrit që operohet nga KEK-u dhe deponisë së Mirashit ? Obiliqi</p> <p>4. A është hartuar plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunën tuaj, konform Ligjit nr. 03/1-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar (<i>shihni nëse Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit janë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis</i>) ?</p>	<p>cilësisë së ajrit;</p> <p>https://prishtinaonline.com/uploads/7_vendim_lidhur_m_e_planin_lokal_te_veprimit_per_cilesin_e_ajrit.pdf</p>	
<p>9.2 Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?</p>	<p>1. Numri i deponive të mëdha ilegale ka qene 5, ndërsa të vogla i kemi pasur rreth 200, pra fjala është për komplet vitin 2023. Drejtoria e Shërbimeve Publike ka nënshkruar kontratë për trajtimin e deponive ilegale, ku është bërë trajtimi i 5 deponive të mëdha (Trudë, Pr, - Fk., l.“Kalabria”, Orloviqi, nën urën Pr. – Fk.) dhe deponive të tjera të vogla. Gjithsej jane larguar rreth 115,035 m³ dhe pastrim i sipërfaqes prej 45,000 m²;</p>	

10. MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT PUBLIK			Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA
10.1 Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues	Drejtoria e Administratës /Drejtoria e shëndetësis	1. A ka pasur fushata vetëdijësues në komunën tuaj lidhur me shëndetin riprodhues ? 2.Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës?	